




Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Punës
dhe Politikës Sociale

PROTOKOLL PËR BASHKËPUNIM NDËRSEKTORIAL SE SI TË VEPROHET ME FËMIJËT NË RRUGË





Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Punës
dhe Politikës Sociale

PROTOKOLL PËR BASHKËPUNIM NDËRSEKTORIAL SE SI TË VEPROHET ME FËMIJËT NË RRUGË





Dokumenti është përpiluar me mbështetje të Programit për
Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ambasadës së Norvegjisë.

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. PJESA TEORIKE	7
1.1 LEGJISLATIVA NACIONALE	7
1.2 DOKUMENTE DHE KONVENTA NDËRKOMBËTARE	9
2. TERME TË PËRDORURA NË KËTË PROTOKOLL	12
3. IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE NË RRUGË	14
4. PROCEDURA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE TË CILËT JANË TË PËRFSHIRË NË JETËN DHE PUNËN NË RRUGË	15
4.1 QENDRA E PUNËVE SOCIALE	15
4.2 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	16
4.3 MINISTRIA E SHËNDETËSISË	17
4.4 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET ARSIMORE	18
4.5 SHOQATAT	19
4.6 NJËSITET E VETËQEVERISJES LOKALE	19




HYRJE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut akoma është aktual problemi me fëmijët në rrugë. Çdo ditë jemi dëshmitarë të numrit të madh të fëmijëve në rrugë të cilët janë të pranishëm në rrugë edhe në kushtet më të pavoritshme klimatike. Zakonisht ata i pastrojnë xhamat e automjeteve, shesin gjësende të vogla, lypin në bulevardet dhe rrugë ku ka frekuentim të madh në komunikacion, me ç'rast e vënë në rrezik jetën e tyre si edhe jetën e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion. Ata shpesh kryejnë edhe punë të tjera, siç janë mbledhja e hekurave të vjetër, ushqimit ose rrobave të vjetra nga kontejnerët për mbeturina ose humbin kohë dhe breddhin rrugëve.

Kur bëhet fjalë për dukurinë e fëmijëve në rrugë/fëmijëve të rrugës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për përcaktimin e termit se në ç'kontekst, mund të thuhet se tek ne gjegjësisht ekzistojnë vetëm fëmijë në rrugë. Shumë prej hulumtimeve dhe analizave kanë treguar se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekzistojnë në kuptimin e vërtetë të fjalës fëmijë të rrugës, por se fëmijë të cilët ekzistojnë në rrugë kanë shtëpi dhe familje, por se gjendja ekonomike e familjeve është në nivel shumë të ulët dhe mungon kujdesi dhe mbrojtja e prindërve. Shumica e familjeve të këtyre fëmijëve marrin ndonjë lloj asistence financiare nga shteti ose nga organizatat ndërkombëtare. Përqindja më e madhe e fëmijëve në rrugë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të nacionalitetit rom, ndërsa më pas pasojnë fëmijët e nacionaliteteve maqedonase, shqiptare, turke dhe të tjera. Aktivitetet më të zakonshme tek fëmijët në rrugë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë grumbullimi i gjësendeve, kryerja e aktiviteteve të punës dhe të tjera, por ndonjëherë janë të pranishme edhe lypja, përtacia, endja/bredhja si edhe kryerja e vjedhjeve, prostitucionit etj.

Fëmijët që lypin, enden rrugëve dhe që punojnë në rrugë njihen si fëmijë në rrugë dhe sipas rregulloreve të kësaj sfere, hyjnë në kategorinë e fëmijëve në rrezik. Fëmijët në rrugë çdo ditë janë më shumë herë të ekspozuar në rrezik për t'u bërë viktimë të llojeve të ndryshme të keqpërdorimit ose neglizhencës për shkak të kushteve të jetesës, mungesës së kujdesit të prindërve, mbrojtjes dhe kontrollit, si edhe qasjes së lehtë për autorët potencial.

Është e evidente nevoja e zbatimit të një aktiviteti të koordinuar për ndihmë dhe mbështetje për këta fëmijë me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të drejtë. Bashkëpunimi midis institucioneve dhe përgjegjësive të tyre lidhur me fëmijët në




rrugë janë rregulluar me një Protokoll shumëdisiplinar për veprim (identifikim dhe udhëzim) me fëmijët në rrugë/fëmijët e rrugës në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2010.

Për shkak të ndryshimeve në legjislativen nacionale që parashohin forma të reja dhe shërbime të mbrojtjes, ndihmë dhe mbështetje të fëmijëve, u imponua nevoja e krijimit të një Protokollit të ri ndërsektorial se si të vepohet me fëmijët në rrugë.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, jepet përgjigjja edhe për arsyeshmërinë e përpunimit të një protokollit të ri. Së pari, ekzistimi i këtij protokollit arsyetohet për shkak të vetë fëmijëve në rrugë të cilët kanë nevojë t'u ndihmohet plotësisht dhe në mënyrë të paanulueshme. Gjithashtu, ekzistimi i këtij protokollit arsyetohet edhe për shkak të nevojës së spektrit të gjerë të procedurave dhe masave të cilat u ofrohen personave profesionistë në mbarë vendin, ndërsa që janë në kontakt me grupin e shënjestruar që i nevojitet mënyrë e unifikuar, e standardizuar dhe unike e veprimit me këta fëmijë.

Protokollin ndërsektorial se si të vepohet me fëmijët në rrugë (në tekstin e mëtejme: Protokollin) është dokument i cili jep udhëzime për veprimin e koordinuar të të gjitha institucioneve dhe shoqatave kompetente që janë të përfshira në mbrojtjen, ndihmesën dhe mbështetjen e fëmijëve në rrugë dhe familjeve të tyre.



1. PJESA TEORIKE

DOKUMENTE KRYESORE PËR ZHVILLIMIN E PROTOKOLLIT

1.1 LEGJISLATIVA NACIONALE

Si sistem i masave dhe aktiviteteve të organizuara për kujdes dhe mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë primare mbrojtja e fëmijëve realizohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 42). Mbrojtja e të gjithë fëmijëve si edhe e fëmijëve në rrugë është përfshirë me një sërë masash edhe atë me:

1. Ligjin për Familjen¹
2. Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve²
3. Ligjin për Mbrojtje Sociale³
4. Ligjin për Drejtësi për Fëmijët⁴
5. Ligjin për Arsim Fillor⁵
6. Ligjin për Arsim të Mesëm⁶
7. Ligjin për Evidentimin Amë⁷

1 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14,104/15, 150/15, Gazeta zyrtare e RMV-së 53/21

2 Gazeta zyrtare e RM-së nr. 23/13, 12/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18, Gazeta zyrtare e RMV-së nr.104/19, 146/19, 275/19, 311/20

3 Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22

4 Gazeta zyrtare e RM-së" nr.148/13, dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 152/19 dhe nr. 275/19

5 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.161/19 dhe 229/20

6 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997,82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007,81/2008, 92/2008, 33/2010,116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012,24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016,67/2017,64/2018 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.229/2020

7 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë"nr. 8/95, 38/02, 66/07, 67/09, 13/13, 43/14, 148/15, 27/16 dhe 64/18 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 14/20



8. Ligjin për Numrin e Amëzës⁸
9. Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi⁹
10. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale¹⁰
11. Ligjin për Financimin e Njësiteve të Vetëqeverisjes Lokale¹¹
12. Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal¹²
13. Ligjin për Shoqata dhe Fondacione¹³
14. Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna mbi Gratë dhe Dhuna në Familje¹⁴
15. Ligjin për Ndihmë Juridike Falas¹⁵
16. Ligjin për Personat e Paevidentuar në Librin Amë të të Lindurve¹⁶
17. Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore¹⁷
18. Ligjin për Sigurim Shëndetësor¹⁸
19. Ligjin për Policinë¹⁹
20. Kodin Penal²⁰
21. Ligjin për Procedurë Penale²¹
22. Ligjin për Kundërvajtje²²

23. Ligjin për Kundërvajtje Kundër Rendit dhe Qetësisë Publike²³

8 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 137/13, nr. 55/16, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 67/22 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 137/13, nr. 55/16, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 67/22

9 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/19

10 Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 5/2002

11 Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09, 47/11 dhe 192/15

12 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09

13 Gazeta zyrtare e RM nr. 52/10, 135/11, 55/16

14 Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 24/21

15 Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 101/2019

16 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.42/2020 dhe 305/2020

17 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 4/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16

18 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/00, 34/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37/06, 18/07, 36/07, 82/08, 98/08, 6/09, 67/09, 50/10, 156/10, 53/11, 26/12, 145/12, 16/13, 91/13, 187/13, 43/14, 44/14, 97/14, 112/14, 113/14, 188/14, 20/15, 61/15, 61/15, 98/15, 129/15, 150/15, 154/15, 192/15, 217/15, 27/16, 37/16, 120/16, 142/16

19 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 114/2006, 6/2009, 145/2012, 41/2014, 33/2015, 31/2016, 106/2016 dhe 120/2016

20 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18

21 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 150/10 dhe nr.100/12

22 Gazeta Zyrtare e M. Veriut nr. 96/2019

23 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.66/07 dhe 152/15



1.2 DOKUMENTE DHE KONVENTA NDËRKOMBËTARE

Republika e Maqedonisë së Veriut futet në vendet të cilat i kanë ratifikuar thuajse të gjitha marrëveshjet kryesore për të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar dhe evropian. Në mesin e marrëveshjeve të ratifikuara për të drejta të njeriut është edhe Konventa për të drejtat e fëmijëve (20/11/1998) që në Maqedoninë e Veriut hyri në fuqi më 17 shtator të vitit 1991. Jo më pak të rëndësishme në radhën e të rëndësishmeve në mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve janë një sërë protokollesh dhe konventa të tjera të cilat i ka ratifikuar Maqedonia e Veriut.

Konventa e KB-së për të drejtat e fëmijëve, marrëveshja më e ratifikuar për të drejta të njeriut në botë, është instrument kryesor obligativ që i përfshin të drejtat, qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve. Republika e Maqedonisë së Veriut, si shtet trashëgimtar i ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, më 2 dhjetor 1993 e pranoi ratifikimin e kësaj konvente.

Konventës për të drejtat e fëmijës, Republika e Maqedonisë së Veriut i ka ratifikuar edhe dokumente të tjera ndërkombëtare:

1. Protokollin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijëve që ka të bëjë me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, i miratuar më 25 maj 2000 1980²⁴
2. Protokollin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijëve që ka të bëjë me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, i miratuar më 25 maj 2000 1980²⁵
3. Konventën për aspektet qytetare – juridike për grabitje ndërkombëtare të fëmijëve, e miratuar më 25 tetor 1980²⁶
4. Konventën evropiane për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të cilat kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve dhe rinovimin e kujdestarisë mbi fëmijët, (ETC 105), e miratuar më 20 maj 1980²⁷
5. Konventën evropiane për statusin ligjor të fëmijëve jashtëmartesorë (ETC 085), e miratuar më 15 tetor 1975²⁸
6. Konventën evropiane për realizimin e të drejtave të fëmijëve (ETC 160), e miratuar më 03 prill 2001²⁹

24 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 44/2003

25 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.44/2003

26 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.07/1991

27 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/2002

28 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/2002

29 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/2002

7. Konventën evropiane për adoptimin e fëmijëve (ETC 058), e miratuar më 03 prill 2001³⁰
8. Konventën për mbrojtjen e fëmijëve dhe për bashkëpunim në fushën e adoptimit ndërkombëtar, e miratuar më 29 maj 1993³¹
9. Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe Protokollin për parandalimin dhe sanksionimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, me të cilin plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe Protokollin kundër kontrabandës së emigrantëve në rrugë tokësore, detare ose ajrore, me të cilën plotësohet Konventa e miratuar më 15 nëntor 2000³²

PARIMET KRYESORE DHE PËRCAKTIMI I TYRE

- E DREJTA E FËMIJËS PËR JETË, MBIJETESË DHE ZHVILLIM
 - MOSDISKRIMINIMI DHE BARAZIA E MUNDËSIVE
 - INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS
 - E DREJTA E PJESËMARRJES SË FËMIJËVE
-

E DREJTA E FËMIJËS PËR JETË, MBIJETESË DHE ZHVILLIM

Република Северна Македонија го признава правото на живот на секое дете со самото раѓање и во најголема можна мера овозможува опстанок и развој на детето.

Ova e pojdovniot, najosnoven princip od koj proizleguvaat site drugi principii кои се однесуваат како на сите деца, така и на децата на улица, а кој е содржан во Уставот на Република Северна Македонија и во националната легислатива.

MOSDISKRIMINIMI DHE BARAZIA E MUNDËSIVE

Republika e Maqedonisë së Veriut i respekton dhe i siguron të drejtat që i përmban Konventa për të drejtat e fëmijës për çdo fëmijë nën jurisdikcionin e saj pa kurrfarë diskriminimi dhe pavarësisht racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, besimit, bindjes politike dhe ndonjë bindje tjetër, origjinës ose statusit tjetër të fëmijës ose të prindit ose kujdestarit të tij ligjor.

Republika e Maqedonisë së Veriut i ndërmer të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e diskriminimit ose dënimet e bazuara mbi statusin, aktivitetet, mendimin ose bindjen e shprehur të prindërve, kujdestarëve ligjorë ose anëtarëve të familjes së fëmijës.

30 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.12/2002

31 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.103/2008

32 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.70/2004

INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS

Në të gjitha aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët, të rëndësishme primare janë interesat e fëmijës, pavarësisht asaj nëse ato i zbatojnë institucionet publike ose private për mbrojtje sociale, organet administrative ose organet ligjdhënëse.

Republika e Maqedonisë së Veriut zotohet fëmijës t'i sigurojë mbrojtje dhe kujdes që është i domosdoshëm për mirëqenien e tij, duke i marrë parasysh të drejtat dhe obligimet e prindërve të tij, kujdestarëve ligjorë ose individëve të tjerë të cilët janë përgjegjës në aspektin ligjor për fëmijën dhe për këtë qëllim i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ligjdhënëse.

E DREJTA E PJESEMARRJES SË FËMIJËS

Fëmijës i cili është i aftë të krijojë mendimin e tij i garantohet e drejta për mendimin e tij, e drejta për ta shprehur lirisht atë mendim për të gjitha çështjet që shqetësojnë fëmijën, duke i kushtuar vëmendje të duhur mendimit të tij në përputhje me vitet e jetës dhe pjekurinë e fëmijës.

Për këtë qëllim, fëmijës veçanërisht i jepet rasti të dëgjohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative të cilat kanë të bëjnë me të, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit ose organit përkatës, në një mënyrë e cila është në pajtim me rregullat procedurale të ligjit nacional.

Fëmija ka të drejtë për lirinë e të shprehurit që e përfshin edhe lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide nga të gjitha llojet, pavarësisht kufijve, qoftë me gojë ose me shkrim ose përmes shtypit, artit ose ndonjë mediumi tjetër sipas zgjedhjes së fëmijës.

QËLLIMI I PROTOKOLLIT

ZHVILLIMI I MËNYRËS SË VEPRIMIT ME FËMIJËT NË RRUGË,
PËRMES NJË QASJEJE TË UNIFIKUAR. SHUMËDISIPLINARE
DHE NDËRSEKTORIALE PËR SHKAK TË SIGURIMIT TË
NDIHMËS. MBËSHTETJES DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE
DHE PËRFSHIRJEN E TYRE NË SHOQËRI PËR REALIZIMIN E
INTERESIT MË TË MIRË TË FËMIJËS.

2. TERME TË PËRDORURA NË KËTË PROTOKOLL

Termi FËMIJËT E RRUGËS/FËMIJË NË RRUGË nuk është i përcaktuar saktë as në literaturën vendore e as në atë botërore. Në përgjithësi me këtë term nënkuptohen personat e mitur të moshës nga 0-18 vjeç të cilët ekzistojnë në rrugë dhe të cilët janë të privuar nga kujdesi familjar.

Sipas UNICEF-it, ky term ndahet në dy nënkategori bazë:

FËMIJË NË RRUGË – fëmijët që e kalojnë shumicën e kohës në rrugë edhe pse i kanë familjet dhe shtëpitë e tyre. Arsyeja më e shpeshtë për këtë është mungesa e kujdesit prindëror, por edhe kushtet e këqija socio-ekonomike të familjeve të tyre. Sjellja e tyre zakonisht reduktohet në grumbullim social premisiv të mbetjeve të lëndëve të para dhe gjësendeve të ndryshme; kryerja e shërbimeve të ndryshme të punës; rishitja, por shpesh sjellja merr kuptim asocial dhe jopremisiv ose jolejues, lypja, humbja e kohës, e ndonjëherë sjellja e tyre është edhe antisociale dhe kriminale duke kryer vjedhje, prostitucion, duke përdorur drogë dhe substanca psikotrope etj.

FËMIJËT E RRUGËS – fëmijë të cilët prej së vërteti jetojnë në rrugë (ose jashtë një mjedisi normal familjar) gjatë gjithë kohës. Këtyre fëmijëve u mungon kujdesi dhe mbrojtja prindërore, pavarësisht nëse janë larguar nga shtëpia/prindërit/kujdestarët apo prindërit/kujdestarët i kanë braktisur ata. Ndonjëherë lidhjet familjare mund të ekzistojnë, por ato janë shumë të dobëta, të rastësishme dhe të parëndësishme në pikëpamje të nevojave të fëmijës për kujdes dhe mbrojtje. Shumicën e kohës ata lypin ose gërmojnë nëpër kontejnerë për të mbijetuar dhe shpesh kryejnë lloje të ndryshme aktiviteteve pune. Ndonjëherë edhe tek këta fëmijë vërehen edhe sjellje asociale apo antisociale, sepse rreziku i ekzistencës është edhe më i madh tek ta.

Në Ligjin e drejtësisë për fëmijët është përcaktuar kuptimi i termeve vijuese:

FËMIJË NË RREZIK është çdo fëmijë që ka mbushur shtatë vjeç dhe nuk ka mbushur 18 vjeç me aftësi të kufizuara fizike ose me pengesa në zhvillimin mendor, viktimë e dhunës, i lënë pas dore në aspektin arsimor dhe social, i cili është në gjendje të tillë që të jetë vështirë ose e pamundur për të përmbushur funksionin edukativ të prindërve, gjegjësisht kujdestarëve, të cilët nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor dhe të edukimit, të përfshirë në lypje, bredhje apo prostitucion, që përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope dhe prekursorë ose alkool, dhe që për shkak të kushteve të tilla janë ose mund të bien në ndesh me ligjin si viktimë ose



si dëshmitar i një veprimi që parashikohet me ligj si kundërvajtje ose i një veprimi që ligji e parashikon si vepër penale.

FËMIJË VIKTIMË është çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, i cili ka pësuar dëmtime, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje materiale ose lëndime të tjera ose kërcënime ndaj të drejtave dhe interesave si rezultat i një veprimi të kryer me ligj si vepër penale.



3. IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE NË RRUGË

DENONCIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE NË RRUGË

Denoncimi për fëmijët në rrugë bëhen në stacionin më të afërt policor ose në numrin 192 ose në Qendrën kompetente për Punë Sociale.

Organi kompetent që e ka marrë denoncimin duhet të marrë informacione bazë për gjendjen në të cilën është vërejtur fëmija, edhe atë:

- vendi, gjegjësisht adresa në të cilën është vërejtur fëmija;
- mosha e fëmijës dhe gjendja e fëmijës – si duket fëmija, përshkrimi i veshjes dhe këpucëve që i mban dhe karakteristika dhe specifika të tjera lidhur me dukjen e fëmijës;
- sjellja dhe rrethanat në të cilat është gjetur fëmija;
- nëse fëmija është vetëm ose në praninë e një personi të rritur;
- rrethana të tjera për të cilat konsideron se mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e veprimit të mëtejme.



4. PROCEDURA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE TË CILËT JANË TË PËRFSHIRË NË JETËN DHE PUNËN NË RRUGË

4.1 QENDRA E PUNËVE SOCIALE

Qendra e Punëve Sociale, punën e saj profesionale për hartimin dhe identifikimin e fëmijëve në rrugë e realizon:

- përmes punës në terren;
- pas denoncimit nga institucione kompetente, organizata ose qytetarë.

LOKALIZIMI DHE IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE NË RRUGË PËRMES PUNËS NË TERREN

Në drejtim të veprimit planifikues dhe të koordinuar të institucioneve kompetente, Qendra e Punëve Sociale dhe Sektori i Punëve të Brendshme realizojnë aktivitete në bazë të një plani të përgatitur paraprakisht dhe në të njëjtin definohen aktivitetet e të gjithë personave (Qendra e Punëve Sociale dhe nëpunësit policorë të Sektorit të Punëve të Brendshme) që veprojnë sipas planit, përcaktohet koha dhe vendi i veprimit.


Puna në terren si pjesë përbërëse e punës së ekipit profesional të Qendrës së Punëve Sociale, kontribuon për lokalizimin më të lehtë dhe evidentimin e fëmijëve në rrugë. Për këtë qëllim, Qendra e Punëve Sociale mund të formojë ekip mobil.

LOKALIZIMI DHE IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE NË RRUGË PAS DENONCIMIT TË INSTITUCIONEVE KOMPETENTE

Çdo institucion, organizatë ose qytetar mund të bëjë denoncim në Qendrën e Punëve Sociale për ndonjë fëmijë në rrugë. Njoftimi regjistrohet në Regjistrin për njoftime të marra për fëmijët në rrezik dhe hapet lëndë për fëmijën.

VEPRIMET E PUNONJËSIT PROFESIONAL/UDHËHEQËSIT TË RASTIT:

- Kur është i njohur identiteti i fëmijës dhe prindërve të tij, Qendra e Punëve Sociale bën vlerësim fillestar për përcaktimin e gjendjes faktike në familje, shkallën e rrezikut dhe kthimin e fëmijës në familje dhe arsyet për të cilat fëmija ndodhet në rrugë.



- Kur nuk është i njohur identiteti i fëmijës dhe prindërve të tij, punonjësi profesional/udhëheqësi i rastit së bashku me nëpunësin policor kompetent ndërmarrin veprime për përcaktimin e identitetit të tyre. Nëse nuk sigurohen prindërit, Qendra e Punëve Sociale ndërmerr masa për përkujdesin e fëmijës.
- Nëse rrezikohet shëndeti dhe jeta e fëmijës dhe ka nevojë për shërbim shëndetësor, punonjësi profesional/udhëheqësi i rastit e shoqëron fëmijën në institucionin përkatës shëndetësor.
- Pas zbatimit të vlerësimit të detajuar të nevojave, rreziqet dhe potencialet e fëmijëve përgatitet Plan individual me aktivitete të definuara, afat, dinamikë dhe zbatuesit. Përcaktohen aktivitetet prioritare për mbrojtjen e fëmijës në realizimin e të drejtave dhe shërbimeve nga sfera e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve.
- Plani individual përmban masa dhe aktivitete të cilat realizohen në bashkëpunim me institucione dhe organizata të tjera varësisht rastit konkret (Agjencisë për Punësim të RMV-së, institucioneve shëndetësore dhe arsimore, shoqatave dhe të tjera)
- Qendra e Punëve Sociale bashkëpunon me institucionet arsimore për përfshirjen e fëmijës në procesin arsimor.
- Punonjësi profesional/udhëheqësi i rastit bën vlerësimin dhe rishikimin e Planit individual, përmes përcaktimit të shkallës së realizimit të aktiviteteve të planifikuara dhe ndërmerren veprime të tjera në drejtim të plotësimit/ndryshimit të planit.

4.2 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Pas denoncimit të marrë (përmes telefonit, me shkrim ose të shtruar drejtpërdrejt në stacion policor) për një fëmijë në rrugë që lypë në vend publik, masa dhe aktivitete ndërmarrin nëpunësit policorë të cilët janë të aftësuar në mënyrë të veçantë për punë për shkatërrimin e delikuencës tek të miturit në pajtim me Ligjin për Procedurë Penale, Ligjin për Drejtësi për Fëmijët dhe Ligjin për Policinë.

Gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nëse nëpunësi policor e has një fëmijë në rrugë, i njëjti është i obliguar të ndërmarrë aktivitete dhe masa përkatëse për largimin e fëmijës nga rruga:

- Në rast kur nga nëpunësi policor në vend publik do të hasë një fëmijë që lypë, paraqitet në SP KP (Stacionin policor me kompetencë të përgjithshme) dhe i njofton nëpunësin policor kujdestar dhe nëpunësin policor për praninë – udhëheqësi i turnit i cili menjëherë e njofton inspektorin për delikuencën e të miturve, gjegjësisht nëpunësin policor të policisë kriminalistike me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme dhe aktiviteteve në pajtim me ligjin.
- Nëpunësi policor i policisë kriminalistike/inspektori për delikuencë për të mitur del në vendin e ngjarjes me automjet civil dhe përcakton nëse fëmija ndodhet në vendin e ngjarjes, nëse fëmija është vetëm ose me praninë e një personi të rritur ose nëse fëmija ndodhet në rrezik.

- NËpunësi policor i policisë kriminalistike/inspektori për delikuencë tek të miturit e identifikon fëmijën, e kontakton prindin dhe e njofton qendrën për punë sociale.
- Biseda udhëhiqet në hapësira të veçanta përkatëse për bisedë me fëmijë.
- NËpunësi policor i policisë kriminalistike/inspektori për delikuencë tek të miturit e thirrë avokatin në situata të përcaktuara me Ligjin për Drejtësi për Fëmijët.

Në drejtim të veprimeve të planifikuara dhe të koordinuara të institucioneve kompetente, Sektori i Punëve të Brendshme dhe Qendra e Punëve Sociale kryejnë aktivitete në bazë të planit të hartuar paraprakisht dhe në të definojnë aktivitetet e të gjithë personave (Qendra e Punëve Sociale dhe nëpunësit policorë të Sektorit të Punëve të Brendshme) që do të veprojnë sipas planit, caktohet koha dhe vendi i veprimit.

Kontakti i parë me fëmijën, pas daljes në terren, duhet të mundësojë një vlerësim fillestar të gjendjes së fëmijës dhe rrethanave të tjera të rëndësishme për sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me ekspertë të institucioneve kompetente.

Kur nëpunësi i policisë vëren se një fëmijë ka lëndime ose është në gjendje të keqe shëndetësore, e njofton shërbimin e urgjencës, si dhe Qendrën kompetente të Punëve Sociale. Një person profesionist nga Qendra e Punëve Sociale dhe një punonjës policie e shoqërojnë fëmijën gjatë ekzaminimit.

Pas veprimeve të ndërmarra, nëse ekzistojnë baza për dyshime se është kryer vepër penale, e cila përndiqet sipas detyrës zyrtare, përpilohet parashtresë përkatëse (kallëzim penal ose njoftim) dhe i dorëzohet prokurorisë publike themelore kompetente.

4.3 MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Punonjësit shëndetësorë në institucionet shëndetësore bashkëpunojnë me personat profesional të Qendrës së Punëve Sociale dhe punonjësit e policisë për të siguruar kujdes shëndetësor në kohë dhe efikas për fëmijët në rrugë. Punonjësit shëndetësorë ofrojnë menjëherë shërbime shëndetësore për fëmijën i cili shoqërohet nga personat profesionistë të Qendrës së Punëve Sociale dhe nëpunësit policorë, në varësi të gjendjes së tij shëndetësore.

Për çdo fëmijë në rrugë të shoqëruar nga një person profesional nga Qendra e Punëve Sociale/nëpunës policor, punonjësit shëndetësorë ofrojnë shërbimin e duhur shëndetësor, përgatisin një raport mjekësor dhe ia dorëzojnë Qendrës së Punëve Sociale/nëpunësve policorë.

Punonjësit shëndetësorë, në bazë të Programit për ofrimin e kujdesit shëndetësor për një kategori të qytetarëve që nuk mund të sigurohen mbi asnjë bazë, ofrojnë mbrojtje shëndetësore dhe kujdes për fëmijët në rrugë (kontrolle sistematike, kontroll dentar, hapje të kartonit të imunizimit dhe zbatim të së njëjtit, trajtim të sëmundjeve dhe udhëzim në institucione për kujdesin dytësor dhe terciar).

4.4 MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE INSTITUCIONET ARSIMORE

Cdo fëmijë ka të drejtën e edukimit dhe arsimimit falas dhe cilësor në shkollën fillore dhe të mesme. Arsimi fillor dhe i mesëm janë të detyrueshëm.

Nëse fëmija nuk regjistrohet në shkollë, shkolla fillore është e detyruar ta njoftojë inspektorin e autorizuar arsimor të komunës ose inspektorin arsimor shtetëror në komunat ku nuk ka inspektor të autorizuar arsimor për fëmijët që nuk regjistrohen në klasën e parë deri më 20 qershor të vitit gjeqës.

Institucionet arsimore bashkëpunojnë me Qendrën për punë sociale për përfshirjen e fëmijëve të rrugës në procesin arsimor. Pavarësisht nëse fëmija ka apo nuk ka dokumente identifikimi (apo është nisur procedura për largimin e tyre), fëmija regjistrohet në një institucion arsimor sipas moshës dhe nevojave individuale të tij.

Pas regjistrimit në shkollë, monitorimin e fëmijës e ndërmerr shërbimi profesional në shkollë në përputhje me Ligjin për arsimin fillor, i cili bashkëpunon me qendrën kompetente për punë sociale dhe e informon për gjendjen e fëmijës, sjelljen e tij në shkollë, suksesin etj. Nëse fëmija regjistrohet në shkollë, por nuk vijon rregullisht, shkolla fillore është e detyruar ta njoftojë inspektorin arsimor të autorizuar të komunës ose inspektorin shtetëror arsimor në komunat ku nuk ka inspektor të autorizuar arsimor për fëmijët për nxënësit që në mënyrë të paarsyeshme nuk shkojnë në shkollë fillore për më shumë se një muaj, në afat prej tri ditëve të punës nga përfundimi i muajit. Vizita në shtëpi në familjet e nxënësve bëhet për nxënësit që mungojnë pa arsye në shkollën fillore për më shumë se një muaj.

Nëse merret informacion se fëmija kalon kohë në rrugë duke lypur dhe aktivitete të ngjashme, menjëherë njoftohet qendra kompetente e punëve sociale.

Për fëmijët e rrugës që nuk janë përfshirë në arsim, dhe që e kanë tejkaluar kufirin e moshës, përgatiten programe mësimore të përshtatura që do të mundësojnë përfshirjen në një klasë të përshtatshme të arsimit fillor.

Për të mbështetur fëmijët në rrugë të nacionalitetit rom, të cilët vijnë nga familje të rrezikuara sociale dhe/ose kanë qenë jashtë sistemit arsimor për një kohë të gjatë mund të shfrytëzohen burimet e ndërmjetësve arsimorë për nxënësit.

4.5 SHOQATAT

Për identifikimin e fëmijëve të rrugës, shoqatat, nëse në mjedisin e tyre vërejnë një fëmijë që mendohet se është fëmijë rruge, duhet të njoftojnë menjëherë policinë në numrin 192, stacionin policor më të afërt ose qendrën më të afërt të punës sociale.

Shoqatat mund të ndërmarrin aktivitete në lidhje me hartimin dhe identifikimin, kërkimin, fushatat dhe mbështetjen e fëmijëve në rrugë dhe familjeve të tyre në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me institucione të tjera.

Njohuritë e marra mund të dorëzohen në institucionet kompetente.

Shoqatat mund të ofrojnë shërbime në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj.

4.6 NJËSITET E VETËQEVERISJES LOKALE

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale e njoftojnë Qendrën kompetente të Punëve Sociale në rast të paraqitjes së fëmijëve në rrugë në territorin e tyre, si me aktivitetet e tyre të rregullta ashtu edhe me veprimet e planifikuara për identifikim.

Në çdo Njësi të Vetëqeverisjes Lokale formohet këshilli komunal për mbrojtje sociale, në të cilin anëtarësohen përfaqësues nga të gjitha institucionet dhe shoqatat përkatëse. Këshilli përgatit një plan social për rajonin e komunës, i cili përmban një hartë të problemeve sociale dhe grupeve të cenushme në komunë, një analizë të kapaciteteve dhe shërbimeve sociale në dispozicion, si dhe nevojat specifike për zhvillimin e shërbimeve sociale në komunë, duke i përfshirë fëmijët në rrugë.

Kryetari i komunës në bazë të planit social, përgatit një program vjetor për mbrojtje sociale, të cilin e miraton Këshilli i komunës.

Në bazë të programeve vjetore të mbrojtjes sociale të komunave dhe opinionit të rajoneve planifikuese, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i planifikon masat, aktivitetet, nevojat dhe kushtet për ndarjen e mjeteve për komunat për zhvillimin e shërbimeve sociale për fëmijët në rrugë.

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale marrin masa për të mbështetur fëmijët në rrugë për ndjekjen e rregullt të arsimit parashkollor dhe procesit arsimor.

